

VENDIM
Nr. 678, datë 2.9.2020

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TEKNIKE E TË KRITEREVE TË SIGURISË, PJESA E TETË, PËR KËRKESAT MINIMALE TË PROJEKTIMIT TEKNIK, NDËRTIMIT DHE OPERIMIT TË SISTEMEVE TË TRANSMETIMIT E TË SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR, TË INSTALIMEVE TË GNL-së, HAPËSIRAVE TË DEPOZITIMIT DHE TË LINJAVE DIREKTE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave teknike e të kriterëve të sigurisë, pjesa e tetë, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes së gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte, për operimin e sigurt të sistemeve të gazit natyror, sipas teksteve bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Në pjesën e tetë të rregullave teknike për industrinë e gazit përfshihen rregulla teknike për sistemin e transmetimit e shpërndarjes, referuar kodeve të praktikave në vazhdim, si më poshtë vijon:

a) Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G 463, korrik 2016, “Linjat e gazit të presionit të lartë, me tuba çeliku për presion operimi mbi 16 bar: ndërtimi”, i përditësuar;

b) Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G 469, korrik 2019, “Metodat e testimit nën presion për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit”, i përditësuar;

c) Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G 499, gusht 2015, “Parangrohja e gazit natyror në impiantet e gazit”, i përditësuar;

ç) Udhëzuesi teknik për industrinë e gazit, kodi i praktikave G 466-1, maj 2018, “Linjat e gazit prej tubash çeliku për një presion operimi më të madh se 16 bar: operimi dhe mirëmbajtja”, i përditësuar;

d) Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G 488, prill 2012, “Impiantet për matjen e cilësisë së gazit: projektimi, ndërtimi, operimi”;

dh) Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G 491, korrik 2010, “Stacionet e rregullimit të presionit të gazit për presionet hyrëse deri në e përfshirë 100 bar: projektimi, fabrikimi, instalimi, testimi, komisionimi dhe operimi”;

e) Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G492, janar 2004, “Stacionet e matjes së gazit për një presion operimi deri në e përfshirë 100 bar: projektimi, fabrikimi, ndërtimi, testimi, komisionimi, operimi dhe mirëmbajtja”;

ë) Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G 497, janar 2008, “Stacionet e kompresorëve”;

f) Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G 497-B1, qershor 2009, suplementi 1 “Zonat me rrezik shpërthimi në stacionet e kompresorëve”.

3. Vendimi nr. 1030, datë 27.11.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave teknike e të kriterëve të sigurisë, pjesa e parë, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes së gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte”, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe